

Hidro Mentori Sh.p.k

Pasqyrat Financiare për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2024

Shumat janë në LEK, përveçse kur shprehet ndryshe

1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Hidro Mentori Sh.p.k (“Shoqëria”) u krijua si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar më datë 29 Prill 2011 dhe u regjistrua me emrin tregtar NT MENTORI Sh.p.k, të cilin e ndryshoi më 16 Janar 2018. Kapitali i shoqërisë përbëhet prej 100 kuotash me vlerë 165.000 lekë secila.

Aktiviteti kryesor i shoqërisë është tregëtimi i artikujve të ndryshëm insustrialë, pajisjeve dhe materialeve të ndryshme për ujësjellës kanalizime.

Adresa e shoqërisë është Rruga Kajo Karafili, H. 2, Ap. 22. Tiranë, Shqipëri.

Gjatë vitit 2024, shoqëria kishte numër mesatar punonjësish prej 9 vetë.

2. BAZA E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE

2.1 Deklarata e përputhshmërisë

Këto pasqyrat financiare, janë për qëllime të përgjithshme raportimi ligjor dhe janë përgatitur në përputhje me Ligjin Nr. 9228 datë 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, të ndryshuar, dhe me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit në Shqipëri të publikuara nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit në Shqipëri dhe të përmirësuara me efekt nga 1 janar 2015.

2.2 Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3 Monedha funksionale dhe ajo e matjes

Pasqyrat financiare janë paraqitur në Lek, e cila është njëkohësisht dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.4 Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që Drejtimi të kryejë gjykime, çmuarje dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto supozime.

Çmuarjet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e çmuarjeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhme nëse ato ndikohen.

2.5 Vlerësimi i menaxhimit mbi vijimësinë e aktivitetit

Drejtimi beson që Shoqëria do të vazhdojë të gjenerojë fitime në të ardhmen dhe aftësia a saj për të vazhduar sipas parimit të vijimësisë nuk do të dëmtohet. Për këtë arsye, Shoqëriaka përgatitur pasqyrat financiare në bazë të parimit të vijimësisë

3. POLITIKAT KONTABËL

Politikat kontabël të përmendura më poshtë janë aplikuar në mënyrë të vazhdueshme në të gjitha periudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare.

a. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivët dhe detyrimet monetarë në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në Lekë me kursin e këmbimit në datën e raportimit. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit njihen përgjithësisht në fitime ose humbje.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2024 dhe 2023 është detajuar si më poshtë:

Monedha	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
1 EUR	98.15	103.88
1 USD	94.26	93.94

Shumat janë në LEK, përveçse kur shprehet ndryshe

b. Instrumenta financiare

Instrumentat financiarë jo-derivative përbëhen nga të drejta të arkëtueshme, mjete monetare dhe ekuivalente të tyre, llogari të financimeve të brendshme, llogari të pagueshme dhe detyrime ndaj palëve të lidhura.

Të gjitha aktivet dhe detyrimet financiare njohen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to. Pas njohjes fillestare, instrumentat financiarë jo-derivative njihen siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur mbarojnë të drejtat kontraktuale të Shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën Shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të Shoqërisë mbarojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat bankare. Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre mbahen me koston e amortizuar në pasqyrën e pozicionit financiar.

Të drejta të arkëtueshme

Të drejtat e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provigjoni për zhvlerësimin e të drejtaave të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se Shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që të drejtat e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provigjoni llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve monetare të ardhshme të skontuara me normën e interesit efektiv.

Llogaritë e pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Vlera e drejtë

Vlera e drejtë e vlerësuar për mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre, të drejtat e arkëtueshme, llogaritë e pagueshme i përafrohen vlerës së tyre kontabël.

c. Aktivet afatgjatë

Njohja dhe matja

Zërat e aktiveve afatgjata materiale maten me kosto minus zhvlerësimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi, nëse ka. Kostoja përfshin shpenzimet e lidhura drejtpërdrejt me blerjen e aktivitetit.

Kur pjesë të një elementi të aktiveve afatgjata materiale kanë jetëgjatësi të dobishme të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra (përbërësit madhor) më vete të aktivitetit. Fitimet dhe humbjet në dispozicion të një zëri të aktiveve afatgjata materiale përcaktohen duke krahasuar të ardhurat nga shitja me vlerën kontabël të elementit dhe njihen për vlerën neto në zërin "të ardhura të tjera" në pasqyrën e të ardhurave.

Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një elementi të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën e mbartur të aktivitetit nëse është e mundur që përfitime ekonomike të ardhshme të trupëzuara do të rrjedhin në kompani dhe kostoja e tij mund të matet me besueshmëri.

Kostot e shërbimit të përditshëm të aktiveve afatgjata materiale njihen në pasqyrën e të ardhurave në momentin kur ndodhin.

Hidro Mentori Sh.p.k

Pasqyrat Financiare për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2024

Shumat janë në LEK, përveçse kur shprehet ndryshe

Amortizimi

Amortizimi njihet në pasqyrën e të ardhurave duke përdorur metodën lineare për përmirësimet e ambjenteve me qira dhe duke përdorur metodën e vlerës së mbetur për të gjitha aktivet e tjera, gjatë jetëgjatësisë së çdo pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale nga dita e parë e muajit pas muajit të blerjes. Aktivet e marra me qira amortizohen përgjatë periudhës më të shkurtër midis afatit të qirasë dhe jetës së tyre të dobishme. Metodat e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi. Normat e amortizimit janë si më poshtë:

- | | |
|------------------------------|----------------------------|
| • Ndërtesa | vlera e mbetur me 5% |
| • Automjete | vlera e mbetur me 20% |
| • Pajisje Zyre & Informatike | vlera e mbetur me 20 – 25% |
| • Aktivet jomateriale | vlera e mbetur me 15% |

d. Zhvlerësimi

Aktivt financiare

Aktivi financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka evidence objektive të zhvlerësimit si pasojë e një apo disa ngjarjeve që kanë ndodhur pas njohjes fillestare të aktivit, të cilat kanë ndikim në flukset monetare që rrjedhin nga aktivi financiar dhe që mund të maten në mënyrë të besueshme.

Humbja nga zhvlerësimi i një aktivi financiar i matur me koston e amortizuar, llogaritet si diferencë mes vlerës së tij të akumuluar dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme monetare, të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivt e rëndësishme financiare testohen individualisht për zhvlërsim në mënyrë periodikë. Pjesa e mbetur e aktiveve shqyrtohen në grupime që kanë karakteristika të ngjashme të riskut të kreditit.

Një humbje nga zhvlerësimi anulohet nëse ky anulim lidhet në mënyrë objektive me një ngjarje të ndodhur pasi është njohur kjo humbje. Për aktivt financiare të llogaritura me koston e amortizuar, anulimi njihet në pasqyrën e të ardhurave.

e. Njohja e të ardhurave

Të ardhurat llogariten me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme dhe përfaqëson shumën e arkëtueshme për shitjen e mallrave në rrjedhën normale të biznesit, duke marrë parasysh skontimet dhe uljet e ofruara. Të ardhurat njihen kur ofrohen shërbimet.

f. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat nga kurset e këmbimit. Shpenzimet financiare përfshijnë humbjet nga kurset e këmbimit.

g. Tatimi mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin aktual i cili njihet në “Pasqyrën e të Ardhurave dhe Shpenzimeve”. Taktimi aktual është tatimi i pritshëm i pagueshëm mbi të ardhurat e tatueshme për periudhën, duke përdorur normat e tatimore të aplikuara në datën e përgatitjes së pasqyrave financiare.

h. Shpërblimet e punonjësve

Kontributet e detyrueshme shoqërore

Kompania nuk bën provizione dhe nuk ka detyrime për pensionet e punonjësve mbi kontributet e paguara në Institutin Shqiptar të Sigurimeve Shoqërore. Kostot respektive në emër të kompanisë njihen në Pasqyrën e të Ardhurave dhe Shpenzimeve, në momentin që ndodhin.

i. Vlerësimet dhe gjykimet e kontabilitetit

Vlerësimet dhe gjykimet shqyrtohen në mënyrë të vazhdueshme dhe bazohen në eksperiencën historike dhe faktorë të tjerë, duke përfshirë pritshmëritë e ngjarjeve të mëvonshme që besohet të jenë të arsyeshme nën rrethanat aktuale. Vlerësimet dhe hipotezat që mbartin riskun e shkaktimit të një rregullimi material në vlerat e mabrtura të aktiveve dhe detyrimeve për vitin e ardhshëm fiskal, janë të listuara më poshtë.

Hidro Mentori Sh.p.k

Pasqyrat Financiare për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2024

Shumat janë në LEK, përveçse kur shprehet ndryshe

Taksat mbi të ardhurat

Kompania është subjekt i taksave mbi të ardhurat në Shqipëri. Për të përcaktuar nivelin e taksave të shtyra mbi të ardhurat nevojitet një gjykim i kujdesshëm. Ka një numër transaksionesh dhe llogaritjesh për të cilat një përcaktim përfundimtar i taksave është i pasigurt. Kompania njihet detyrimet për çështje të pritshme që lidhen me auditimin fiskal bazuar në vlerësimet nëse do të ketë taksa shtesë për t'u paguar.

4. PARA NË ARKË DHE BANKË

Paraja cash dhe ekuivalentët e tyre më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023 janë si vijon:

	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
I. Para në arkë	168,819	159,828
Në monedhë vendase	87,987	17,130
Në monedhë të huaj	80,833	142,698
II. Para në bankë	9,860,031	33,954,699
Në monedhë vendase	586,424	8,379,653
Në monedhë të huaj	9,273,607	25,575,046
Total Mjete Monetare (I+II)	10,028,850	34,114,527
Garanci bankare	3,042,650	2,181,480
Totali i parasë në arkë dhe bankë	13,071,500	36,296,007

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre përbëhen nga llogaritë në lekë dhe në monedhë të huaj që shoqëria ka pranë bankave të nivelit të dytë në Shqipëri si dhe gjëndja e arkës në datën e raportimit.

5. LLOGARI TË ARKËTUESHME

Llogari të arkëtueshme nga klientët më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023 përbëhen si më poshtë:

	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
Të arkëtueshme nga klientë	402,073,059	224,833,083
Llogari të arkëtueshme neto	402,073,059	224,833,083

Llogaritë e arkëtueshme përfshijnë të arkëtueshme nga klientët për shitjen e mallrave dhe produkteve të tjera nga aktiviteti kryesor i Shoqërisë.

6. LLOGARI TË TJERA TË ARKËTUESHME

Llogari të arkëtueshme të tjera më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023 përbëhen si më poshtë:

	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
Tatim fitimi i arkëtueshëm	318,498	823,419
Parapagime në doganë	9,331	137,962
TVSH e arkëtueshme	-	10,611,048
Totali	327,829	11,572,429

7. INVENTARË

Inventarët më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023 përbëhen si më poshtë:

	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
Mallra për shitje	28,410,885	53,922,321
Totali	28,410,885	53,922,321

Hidro Mentori Sh.p.k

Pasqyrat Financiare për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2024

Shumat janë në LEK, përveçse kur shprehet ndryshe

8. PARAPAGIME

Parapagimet për furnizime më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023 përbëhen si më poshtë:

	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
Parapagime për furnizime	1,013,552	44,124,548
Totali	1,013,552	44,124,548

9. AKTIVE TË TJERA

Aktive të tjera më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023 përbëhen si më poshtë:

	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
Hua palëve të lidhura (HM Kosovë)	71,686,797	91,100,684
Hua palëve të treta	65,302,841	69,031,155
Hua palëve të lidhura	7,743,612	46,308,750
Parapagime për qira	35,334	37,396
Totali	144,768,583	206,477,985

Aktive të tjera përfaqësojnë ndihma afatshkurtra me të drejtë kthimi ndaj Hidro Mentori Kosovë, shoqëri që zotërohet nga aksionari i vetëm, dhe palëve të treta.

10. AKTIVET AFATGJATA MATERIALE

	Ndërtesa	Mjete transporti	Pajisje zyre	Pajisje informatike	Të Tjera	Totali
<i>Kosto</i>						
Më 1 janar 2023	15,277,830	14,680,557	3,899,173	2,996,477	1,099,142	37,953,179
Shtesa	-	-	-	1,534,018	-	1,534,018
Pakësime	-	(1,300,000)	-	-	-	(1,300,000)
Më 31 dhjetor 2023	15,277,830	13,380,557	3,899,173	4,530,495	1,099,142	37,088,055
Shtesa	-	13,567,500	42,500	195,816	-	13,805,816
Pakësime	-	-	-	-	-	-
Më 31 dhjetor 2024	15,277,830	26,948,057	3,941,673	4,726,311	1,099,142	50,893,871
<i>Amortizim i akumuluar</i>						
Më 1 janar 2023	(2,779,364)	(8,442,443)	(1,880,338)	(1,429,675)	(382,452)	(14,531,820)
Amortizimi i viti	(624,923)	(1,187,571)	(403,767)	(607,580)	(143,338)	(2,967,179)
Pakësime	-	828,163	-	-	-	828,163
Më 31 dhjetor 2023	(3,404,287)	(8,801,851)	(2,284,105)	(2,037,255)	(525,790)	(17,053,288)
Amortizimi i viti	(593,677)	(874,537)	(328,680)	(658,550)	(114,670)	(2,570,114)
Pakësime	-	-	-	-	-	-
Më 31 dhjetor 2024	(3,997,964)	(9,676,388)	(2,612,785)	(2,695,805)	(640,460)	(19,623,402)
<i>Vlera e mbartur</i>						
Më 31 dhjetor 2022	12,498,466	6,238,114	2,018,835	1,566,802	716,690	23,038,907
Më 31 dhjetor 2023	11,873,543	4,578,706	1,615,068	2,493,240	573,352	21,133,909
Më 31 dhjetor 2024	11,279,866	17,271,669	1,328,888	2,030,506	458,682	32,369,611

Hidro Mentori Sh.p.k

Pasqyrat Financiare për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2024

Shumat janë në LEK, përveçse kur shprehet ndryshe

11. HUA AFATSHKURTËR

Hua afatshkurtër më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023 përbëhen si më poshtë:

	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
Hua afatshkurtër Raiffeisen Bank	27,707,058	5,738,707
Porsche Leasing	2,265,608	-
Hua afatshkurtër Credit Card	492,441	529,802
Totali	30,465,107	6,268,509

Hua afatshkurtër përfaqëson detyrimin në formë overdraftit që shoqëria ka pranë Raiffeisen Bank si dhe detyrimin për kartën e kreditit në emër të shoqërisë.

12. ARKËTIME NË AVANCË

Arkëtime në avancë më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023 përbëhen si më poshtë:

	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
Paradhënie të marra	67,264,192	68,469,710
Totali	67,264,192	68,469,710

Arkëtime në avancë më 31 dhjetor 2024 në shumën prej 67,264,192 Lekë përfaqësojnë parapagimet e marra nga shoqëria për porosi të kryera në vitin 2024 por ende të pa dorëzuara tek klientet.

13. TË PAGUESHME NDAJ FURNITORËVE

Të pagueshme ndaj furnitorëve më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023 janë si më poshtë:

	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
Furnitorë për mallra dhe shërbime	44,285,754	34,168,413
Totali	44,285,754	34,168,413

14. DETYRIME TATIMORE

Detyrimet tatimore më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023 përbëhen si më poshtë:

	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
Tatimi mbi vlerën e shtuar	9,582,572	-
Kontributet shoqërore e shëndetësore	268,984	221,411
Tatimi mbi të ardhurat nga punësimi	230,877	202,340
Tatimi i mbajtur në burim	21,173	18,122
Të pagueshme ndaj punonjësve	5,784,080	-
Totali	15,887,686	441,873

15. DETYRIME TË TJERA

Detyrimet të tjera më 31 dhjetor 2024 në vlerë 15,260,961 lekë përfaqëson detyrimin e shoqërisë ndaj klientëve për parapagime të arkëtuara.

16. KAPITALI I PAGUAR

Më 31 dhjetor 2024 aksionari i vetëm i Shoqërisë është Z. Mentor Kadrijaj. Kapitali i regjistruar i Shoqërisë më 31 dhjetor 2024 është 203,000,000 LEK (2023: 203,000,000 LEK) i përbërë nga 100 kuota me vlerë nominale 203,000 LEK secila.

17. REZERVA

Rezerva të krijuara nga Shoqëria më 31 dhjetor 2024 kanë një vlerë prej 187,000,000 LEK (2023: 197,129,798LEK).

Hidro Mentori Sh.p.k

Pasqyrat Financiare për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2024

Shumat janë në LEK, përveçse kur shprehet ndryshe

18. TË ARDHURAT

Të ardhurat më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023 përbëhen si më poshtë:

	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
Shitje mallrash	598,781,781	764,684,371
Shërbime dhe të tjera	9,447,833	4,785,917
Shitje asetesh	-	216,380
Totali	608,229,615	769,686,668

Të ardhurat e deklaruar ne FDP e tatim fitimit për vitin 2024 nuk përputhen me ato të deklaruar në FDP-të në e-tax në www.tatime.gov.al për shumën prej 1,205,518 Lekë më pak, të cilat përfaqësojnë arkëtime në avancë (parapagime të marra) sic paraqitet pasive të bilancit (shiko shënimi shënimi 12 më sipër).

19. KOSTO E MALLRAVE TË SHITUR

	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
Gjëndje në fillim	53,922,321	32,083,084
Blerje gjatë vitit	346,882,519	578,751,331
(Gjëndje në fund)	(28,410,885)	(53,922,321)
Totali KMSH	372,393,954	556,912,094

20. SHPENZIME PËR PERSONELIN

Shpenzimet për personelin më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023 përbëhen si më poshtë:

	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
Pagat e punonjësve	10,263,692	9,321,370
Kontributet e sigurimeve	1,511,615	1,334,694
Totali	11,775,307	10,656,064

21. SHPENZIME OPERATIVE

Shpenzimet operative më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023 përbëhen si më poshtë:

	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
Shpenzime për udhëtime e dieta	8,190,338	5,822,857
Udhëtime e dieta	4,336,472	8,326,828
Shpenzime për pritje e përfaqësime	2,080,367	592,489
Mirëmbajtje dhe riparime	2,005,637	4,504,949
Qira	1,632,528	1,449,760
Shpenzime doganore	1,246,519	3,539,846
Shpenzime transporti	1,229,826	5,179,955
Shërbime bankare	1,072,816	1,128,527
Energji, karburant etj.	728,730	931,240
Sigurime për mallrat dhe asetet	678,783	585,774
Taksa dhe tarifa të ndryshme	645,734	782,460
Shërbime profesionale nga të tretët	615,268	613,536
Shpenzime telekomunikacioni dhe postare	326,393	300,959
Shpenzime të tjera administrative	47,763	7,542,138
Humbje nga mosarkëtimi	-	29,496,902
Vlera e asetëve të shitura	-	216,380
Gjoha dhe penalitete	-	209,946
Totali	24,837,175	71,224,544

Hidro Mentori Sh.p.k

Pasqyrat Financiare për vitin që mbyllet më 31 Dhjetor 2024

Shumat janë në LEK, përveçse kur shprehet ndryshe

22. SHPENZIME FINANCIARE

Shpenzimet financiare më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023 përbëhen si më poshtë:

	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
(Fitime) nga kurset e këmbimit	(6,765,681)	(12,208,891)
Humbje nga kurset e këmbimit	132,912,147	119,086,003
Totali i humbjeve nga kurset e këmbimit	126,146,465	106,877,112
(Të ardhura) nga interesat	(995)	(825)
Shpenzime për interesat	481,958	177,184
Totali i shpenzimeve për interesa	480,963	176,360
Shpenzime financiare neto	126,627,428	107,053,471

23. TATIMI MBI FITIMIN

Shoqëria përcakton tatimin në fund të vitit në përputhje me legjislacionin tatimor shqiptar, Në vitin 2024, norma e tatim fitimit në Shqipëri ishte 15%, (2023: 15%). Më poshtë paraqitet rakordimi i tatim fitimit të përlogaritur me normat përkatëse me shpenzimin e tatimit:

	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
Fitimi para tatimit	70,025,636	20,873,316
Shpenzime të pazbritshme	4,336,472	45,654,134
Fitimi /(humbja) tatimore për vitin	74,362,108	66,527,450
Tatimi mbi fitimin 15%	(11,154,316)	(9,979,117)
Fitimi NETO i vitit	58,871,320	10,894,199

Shpenzimet e pazbritshme lidhen me shpenzime që sipas Ligjit Shqiptar nuk mund t'i zbriten llogaritjes së fitimit/humbjes së tatueshme.

	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
Shpenzime te panjohura	4,336,472	8,326,828
Humbje nga mosarketimi	-	29,640,000
Shpenzime dieta te Panjohura	-	7,477,360
Gjoke Tatim Fitimi	-	209,946
Totali	4,336,472	45,654,134

Më poshtë paraqitet rakordimi i normës efektive të tatimit:

	31 Dhjetor 2024	Norma efektive tatimore	31 Dhjetor 2023	Norma efektive tatimore
Fitimi i vitit	70,025,636		20,873,316	
Tatimi mbi fitimin 15%	10,503,845	15.00%	3,130,997	15.00%
Tatimi për shpenzimet e pazbritshme	650,471	0.93%	6,848,120	32.81%
Totali i tatimit mbi fitimin	11,154,316	15.93%	9,979,117	47.81%

24. ANGAZHIME DHE KUSHTËZIME*Angazhime*

Shoqëria nuk ka angazhime materiale të nënkontraktuara në datën e pasqyres së pozicionit financiar të cilat të mos jenë reflektuar në pasqyrat financiare.

Detyrime tatimore

Librat dhe të dhënat kontabël për vitet financiare që përfundojnë më 31 dhjetor 2024 dhe 2023 nuk janë audituar nga autoritetet tatimore. Si rrjedhim, detyrimet tatimore të Shoqërisë mund të mos konsiderohen të finalizuara.

Çështje Gjyqësore

Në rrjedhën normale të biznesit, Shoqëria ndeshet me pretendime ligjore dhe gjyqësore; menaxhimi i Shoqërisë është i mendimit se asnjë humbje materiale nuk do të shkaktohet në lidhje me kërkesat ligjore të pazgjidhura më 31 dhjetor 2024.

25. NGJARJE PAS PERIUDHËS RAPORTUESE

Nuk ka ngjarje të rëndësishme të ndodhura pas datës së mbylljes së pasqyrave financiare që kërkon rregullime të pasqyrave financiare ose dhënie të shpjegimeve plotësuese për to.